REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

Data: 23.5.2023 | Nr: 551 | Ora: 15:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË SKRAPAR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenit 162 dhe nenit 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VËREN:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "i", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 80, datë 15.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Skrapar. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ-së nuk rezulton të jetë bërë ankim brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe nenit 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për subjektet zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Skrapar pasqyrohet në tabelën nr.1, në vijim:

(Tabela nr.1)

| Nr. FV | Subjekti Zgjedhor | Vota | Përqindja |
|---|---|---|---|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 1844 | 29,96 |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 2752 | 44,72 |
| 3 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | 228 | 3,70 |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 403 | 6,55 |
| 6 | Partia Demokracia Sociale | 194 | 3,15 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 8 | Partia Socialdemokrate | 470 | 7,64 |
| 9 | Partia Demokratike | 263 | 4,27 |
| | **Totali** | **6154** | 100% |

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Skrapar, në bazë të shkresës nr. 157/2 Prot., datë 16.3.2023 të Prefektit të Qarkut Berat.

Herësit e përfituar nga ky pjesëtim janë në tabelën nr. 2 , që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim:

(Tabela nr. 3)

| **Nr.** | **Herësi** | **Subjekti** |
|---|---|---|
| 1 | 2752 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 2 | 1844 | Bashkë Fitojmë |
| 3 | 1376 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 4 | 922 | Bashkë Fitojmë |
| 5 | 917 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 6 | 688 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 7 | 614 | Bashkë Fitojmë |
| 8 | 550 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 9 | 470 | Partia Socialdemokrate |
| 10 | 461 | Bashkë Fitojmë |
| 11 | 458 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 12 | 403 | Partia Republikane Shqiptare |
| 13 | 393 | Partia Socialiste e Shqipërisë |
| 14 | 368 | Bashkë Fitojmë |
| 15 | 344 | Partia Socialiste e Shqipërisë |

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr. 3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim:

(Tabela nr. 4)

| Nr. në FV | Subjekti Zgjedhor | Mandate |
|---|---|---|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 5 |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 8 |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 1 |
| 8 | Partia Socialdemokrate | 1 |

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga KZAZ-ja.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "i", e 2, nenin 162 dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**VENDOS:**

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Skrapar, si më poshtë:

| Nr. në FV | Subjekti Zgjedhor | Mandate |
|---|---|---|
| 1 | Bashkë Fitojmë | 5 |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | 8 |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | 1 |
| 8 | Partia Socialdemokrate | 1 |

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Skrapar, si më poshtë:

**Bashkë Fitojmë**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Mimoza | Xhevit | Zylyftari |
| 2. | Fikret | Flamur | Telha |
| 3. | Albana | Veli | Hoxha |
| 4. | Hajredin | Lahe | Bakiasi |
| 5. | Valbona | Tosun | Gropa |

**Partia Socialiste e Shqipërisë**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Enver | Hysen | Caka |
| 2. | Liri | Hysmet | Nuhellari |
| 3. | Skerdilajt | Ikmet | Jaupllari |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4. | Alma | Estref | Kadiasi |
| 5. | Arjan | Skënder | Hasa |
| 6 | Elsa | Adil | Petritaj |
| 7. | Edmond | Samit | Kalemi |
| 8. | Mimoza | Elmas | Hysaj |

**Partia Republikane Shqiptare**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Pëllumb | Barjam | Guri |

**Partia Socialdemokrate**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Myqerret | Reshat | Hebibasi |

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

**Bashkia Skrapar, herësit** **Tabela nr. 2**

| Nr.në FV | SUBJEKTI | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkë Fitojmë | BF | 1844 | 922 | 614 | 461 | 368 | 307 | 263 | 230 | 204 | 184 | Herësat |
| 2 | Partia Socialiste e Shqipërisë | PS | 2752 | 1376 | 917 | 688 | 550 | 458 | 393 | 344 | 305 | 275 | |
| 3 | Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë | P.A.A | 228 | 114 | 76 | 57 | 45 | 38 | 32 | 28 | 25 | 22 | |
| 4 | Partia Republikane Shqiptare | PR | 403 | 201 | 134 | 100 | 80 | 67 | 57 | 50 | 44 | 40 | |
| 6 | Partia Demokracia Sociale | P.D.S | 194 | 97 | 64 | 48 | 38 | 32 | 27 | 24 | 21 | 19 | |
| 8 | Partia Socialdemokrate | PSD | 470 | 235 | 156 | 117 | 94 | 78 | 67 | 58 | 52 | 47 | |
| 9 | Partia Demokratike | PDSH | 263 | 131 | 87 | 65 | 52 | 43 | 37 | 32 | 29 | 26 | |